

## FTESË PËR APLIKIM

**Programi:** Shkollim, Aftësim dhe Punësim në Gjermani  
**Profesioni:** Të ndryshme: Elektricitë, Ndërtimtari, Vozitës Kamioni, Përpunues i mishit, Ndërtues i rrugëve dhe Depoist  
**Gjenerata:** II - 2022/2023, Projekti 222

APPK Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë dhe BBQ- Bildung und Berufliche Qualifizierung nga Gjermania, kanë arritur marrëveshjen për përzgjedhjen e 21 të rinjve Kosovar të cilëve u ofrohet një program i Shkollimit dhe Aftësimin Profesional trevjeçar (Ausbildung), duke vazhduar me punësim të menjëhershëm dhe të përhershëm, për disa profesione si në vijim:

Pos.	Profesioni i emërtuar sipas Standardeve Gjermane	Profesioni/profili që ofrohet në Kosovë dhe me të cilin/at mund të aplikohet	Nr. i Pozitave
221.1	Vozitës Profesional i Kamionëve ( <i>Berufskraftfahrer</i> )	Transport rrugor ose profesione/kualifikime tjera të ngjashme;	3
221.2	Ndërtues të Rrugëve ( <i>Straßenbauer</i> )	Operator i trafikut rrugor, Beton punues ose profesione/kualifikime tjera të ngjashme;	6
221.3	Elektricitist i sistemit të Informacioneve ( <i>Informationselektroniker</i> )	Teknik i elektronikës, Instalues elektrik, Elektroteknikë ose profesione/kualifikime tjera të ngjashme;	2
221.4	Elektricitist për Energji dhe Objekte Banimi ( <i>Elektroniker für Energie – und Gebäudetechnik</i> )	Energjetikë, Teknik i elektronikës, Instalues elektrik, Elektroteknikë ose profesione/kualifikime tjera të ngjashme;	3
221.5	Murator ( <i>Maurer</i> )	Murator, Ndërtimtari, Ndërtim i thatë ose profesione/kualifikime tjera të ngjashme;	3
221.6	Deponues Profesional ( <i>Fachlagerist</i> )	Shpedicion dhe logjistike ose profesione/kualifikime tjera të ngjashme;	2
221.7	Përpunues mishi ( <i>Fleischer</i> )	Përpunues i mishit ose profesione/kualifikime tjera të ngjashme;	2

**APPK fton të interesuarit për APLIKIM sipas kushteve në vijim:**

**Nëse Ju:**

- Keni të përfunduar Shkollimin e Mesëm në njërin prej profesioneve/profileve të cekura në tabelën më lartë;
- Jeni të gatshëm të bashkë-investoni në mësimin e gjuhës Gjermane në Kosovë, për rreth 7 muaj. Njohja paraprake e gjuhës Gjermane nuk është parakusht për t'u pranuar në Program.
- Jeni të gatshëm dhe shumë të motivuar për vijimin e Shkollimit dhe Aftësimin Profesional trevjeçar në Gjermani, për njërin prej profesioneve të lartcekura, të cilin mund ta zgjidhni në formularin e aplikimit.

**Ju ofrohet:**

- Mësimi i gjuhës Gjermane, deri në nivelin B1, sipas metodave më bashkëkohore, i domosdoshëm për të vazhduar programin Shkollimin dhe Aftësimin Profesional në Gjermani.
- Vijim i programit të Shkollimit dhe Aftësimit profesional, pa asnjë shpenzim financiar, të gjitha mbulohen nga programi.

Të interesuarit mund të aplikojnë në formën online, përmes linkut

<https://forms.gle/eSW1SnHqocmzMwYz7> më së largu deri me **21.08.2022**.

Nëse ju duhet ndonjë informacion shtesë, ju lutem na shkruani në [aplikimet.appk@gmail.com](mailto:aplikimet.appk@gmail.com) ose në tel. +38344507628,

E mirëpresim aplikimin Tuaj

APPK